

Të Nderuar Anëtarë të Asamblesë të IEKAs !

Kam zgjedhur të kandidoj për udhëheqjen e organizatës sonë ,sepse besoj fort në rolin që kjo organizate ka për forcimin e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë publike. Me pervojën dhe përkushtimin tim, dua të kontribuoj që organizata jonë të bëhet një model profesionalizmi, ku etika dhe cilësia e auditimit janë prioritet në çdo veprim.

Organizimi ynë profesional (IEKA) ndodhet në një moment shume te rëndësishëm. Roli qe ai ka ne mbrojtjen e interesit publik, është jetik edhe për funksionimin e ekonomisë se tregut ne vendin tone. Vitet e fundit, ne kemi përjetuar jo thjesht dhe vetëm sfida profesionale, qe janë te natyrshme ne kushtet e rritjes se shkalles se përdorimit te teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, por edhe te organizimit dhe funksionimit, te cilat deri diku e kanë cenuar rolin e Institutit si një partner i besueshëm për anëtarët dhe institucionet. Vërehet se roli i IEKAs, është zvogëluar, dhe gati është bere i njëjtë me atë te organizmave te tjera, kur duhet te ishte i forte dhe me nje lidership te padiskutueshëm.

Angazhimi im kryesor si anëtar i Këshillit do te jete i fokusuar ne këto dy drejtime te rëndësishme :

(a) në rritjen e besimit ndaj IEKAs, duke përmirësuar reputacionin për anëtarët dhe institucionet rregullatore, publike dhe qeveritare si dhe forcimi i rolit ne aspektin ndërkombëtar; dhe

(b)mbrojtja e anëtareve, duke nxitur profesionalizmin, llogaridhënien dhe transparencën me fokus kryesor tek etika dhe një menaxhim sa me efektiv i cilësisë.

Ky program bazohet në parimet e Integritetit, Objektivitetit, profesionalizmit, përfshirjes dhe lidershipit.

1. Audituesit ligjore, anëtarë te IEKAs në Qendër te veprimtarisë. Besimi humbet kur marrëdhënia është e pa balancuar.

- Do te punoj që të garantohet se zëri i anëtarit do të dëgjohej, vendimet të jenë të kuptueshme dhe Organizmi të jetë vërtet i tyre. Kjo do te realizohet përmes transparencës së plotë në vendimmarrje dhe llogaridhënies edhe sa i takon shpenzimeve Financiare

- Të gjitha veprimtaritë, përfshirë vendimet e Këshillit, procesverbalet kryesore dhe buxheti vjetor do të publikohen në mënyrën e duhur dhe në një format të kuptueshëm, ku anëtarët të kenë aksesin e nevojshëm, duke mbrojtur te drejtat e tyre.
- Do të studiohet mundësia e krijimit të një pike kontakti të pavarur për adresimin e ankesave dhe marrjen e reagimeve nga të tretet. Ky funksion do të sigurojë që çdo shqetësim i anëtarëve në lidhje me Organizmin ose marrëdhëniet me palët e treta (institucione, biznese, etj.) të hetohet me shpejtësi dhe paanshmëri.
- Përfshirje e anëtarëve në vendimmarrje
- Krijimi i Grupeve të Punës për çështje të caktuara: Do të punoj për të angazhuar vullnetarisht anëtarët sipas nivelit të ekspertizës (Tatime, Auditim, shërbime të tjera, raportime dhe auditime për qëndrueshmërinë), për të asistuar jo vetëm Këshillin por edhe anëtarët si dhe për të ndihmuar Institucionet në kuadër të hartimit të ligjeve që e përafrojnë legjislacionin shqiptar me atë të BE-se. Këto rezultate do të jenë burimi kryesor i ekspertizës teknike përpara se Këshilli të miratojë qëndrime zyrtare.
- Këshillimi me anëtarët: Për çështjet madhore (tarifat, ndryshimet e rregulloreve, qëndrimet ndaj ligjeve të reja), do të punoj që të zbatohet një proces i detyrueshëm konsultimi publik me anëtarët përmes platformave dixhitale, përpara se projektvendimet t'i dërgohen asamblesë për vendimmarrje finale.

2. Përmirësimi i marrëdhënieve me institucionet, në funksion të rritjes së reputacionit të IEKAs

Për të rifituar rolin tonë që na takon si lider i profesionit, ne duhet të jemi zëri më i fortë dhe më i besueshëm për profesionin në vend. Për këtë qëllim do të punoj për të fuqizuar dhe përmirësuar marrëdhëniet me Institucionet brenda dhe jashtë vendit.

- Organizmi duhet të bëhet partneri kryesor këshillues i institucioneve qeveritare, duke mos pritur draft-ligjet, por duke ofruar vetë propozime konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor.
- Organizmi do të kontribuojë me ekspertizën e anëtarëve për të bërë analiza mbi çështje me rëndësi ekonomike (p.sh., Analizë e Cilësisë së Raportimit Financiar

në Shqipëri, Impakti i Reformave Tatimore), duke rritur kështu vlerën dhe kredibilitetin tonë publik.

- Këshilli do të jetë një mbrojtës i dinjitetit dhe të drejtave ligjore të anëtarëve, duke ofruar mbështetje ligjore dhe morale kur ata hasin padrejtësi në marrëdhëniet me institucionet publike.
- Do të konsiderohen në kushtet e një partneriteti të drejtë marrëdhëniet me Bordin e Mbikëqyrjes publike, duke e shndërruar IEKAN në një partner shumë të besueshëm.

3. Standardet, Cilësia dhe Etika.

Standardet profesionale, etike dhe cilësia nuk janë opsione, por themelet e profesionit tonë. Do të punoj për rishikimin e plotë të Kodit të Etikës së IEKAs, në linjë me zhvillimet me të fundit të Kodit IESBA, përfshirë edhe ndryshimet për raportimin dhe auditimin e qëndrueshmërisë. Do të punoj për një zbatim rigoroz të Kodit të Etikës të IEKAs

- Forcimi i Komisionit të Etikës dhe Disiplinës: Do të punoj që të siguroj pavarësi të plotë, burime të mjaftueshme dhe trajnim specifik për anëtarët e këtij komisioni, për të garantuar trajtim të drejtë dhe të barabartë të çdo shkeljeje etike, pa ndikime apo favorizime.
- Edukimi i Vazhdueshëm në lidhje me standardet profesionale dhe Etikën: Çdo program i Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm (CPD) do të ketë një modul të detyrueshëm mbi sfidat etike dhe zbatimin e Kodit të Etikës në praktikë.

4. Menaxhimi i cilësisë

- Rritja e rolit të IEKAs në kontrollin e cilësisë së punës të anëtarëve: Rishikimi dhe forcimi i sistemit të kontrollit të cilësisë për të siguruar që standardet profesionale të zbatohen siç duhet. Ky proces duhet të jetë më ndihmues dhe edukues dhe jo vetëm penalizues.
- Do të përjashtohen nga Kontrolli një numër auditimesh për SME-te, duke u mjaftuar me një sistem monitorimi që do të bazohet në vetë deklarin e anëtarëve dhe kontrole të thelluara vetëm, në rast ankesash nga anëtarët ose të tretet.

- **5: Modernizimi i Shërbimeve për Anëtarët dhe stazhieret.**

Ne duhet të shohim përpara dhe t'i pajisim anëtarët me mjetet që u duhen për të qenë të suksesshëm në të ardhmen. Përmirësim i Zhvillimit Profesional të Vazhdueshëm (CPD)

- Fokus në Kompetencat e së Ardhmes: Zhvillimi i moduleve të reja trajnimi që adresojnë fushat e pambuluara si: Raportimi i Qëndrueshmërisë (ESG), Analizat Financiare të Avancuara (Big Data) dhe Mbrojtja Kibernetike në Kontabilitet.
 - Sistemi i Burimeve Online: Krijimi i një platforme digitale gjithëpërfshirëse ku anëtarët mund të gjejnë shpejt përditësimet ligjore, udhëzues praktikë, studime rasti dhe literaturë profesionale, të gjitha pa kosto shtesë.
- Përmirësimi i edukimit për stazhieret, duke punuar edhe për marrëveshje njohje me ACCA
- Programi i udhëheqjes së stazhiereve, do të ketë në qendër monitorimin e stazhit me qëllim që stazhieret të fitojnë aftësitë e duhura ndërpresonale, të komunikimit dhe personale.
- Do të punoj të përmirësohet procesi i testimit profesionalë përfundimtar që sot realizohet nga autoriteti i certifikimit.
- Profesionalistët e rinj të lidhen me mirë anëtarët me përvojë, duke ndihmuar në transferimin e njohurive dhe standardeve etike.

Të Nderuar Anëtarë të Asamblesë të IEKAs !

Ju ftoj të më besoni votën tuaj jo për premtime, por për një përgjegjësi dhe angazhim të sinqertë që IEKA të bëhet më i fortë, më transparent dhe më përfaqësues. Së bashku mund të ndërtojmë një organizatë që respekton standardet më të larta profesionale dhe që mbetet gjithmonë në shërbim të së vërtetës dhe integritetit.

Ju Faleminderit !

Arqile Mishtaku

